



01 Nr.06-350/ 02-4729/22
Kačanik 27.07.2022

NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 dhe 8.2 të nenit 8 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28.07.2010 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës nr 01Nr.06-350/02-4729/22, njoftohen të gjithë subjektet e listuara në Vendimin e bashkangjitur këtij njoftimi se:

1. Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke e marr parasysh Interesin Publik, ku Shkolla Fillore "Qamil Ilazi" e cila është funksionale dhe hapsirat e larëshënuara i shfrytëzon për oborr dhe fusha sportive për afro 20 vite të cilat hapsira janë të rrethuara së bashku me shkollën, duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 Kryetari i Komunës ka miratuar Vendimin nr 01Nr.06-350/02-4729/22, për shqyrtimin e mëtejme të procedurës së shpronësimit të pronës së paluajtshme.

2. Kryetari i Komunes do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30 ditësh pas përmbushjes së kushteve të parapara nga neni 9 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205, lidhur me organizmin e dëgjimeve publike.

3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

4. Komuna do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar pra për parcelat kadastrale nr nr.01306-2, me kulturë kullosë e klasës 4 , me sipërfaqe prej 600 m², Z.K Kačanik i Vjetër dhe 01306-8 me kulturë kullosë e klasës 4 , me sipërfaqe prej 600 m², Z.K Kačanik i Vjetër.

5. Të gjithë personat të cilët janë zyrtare publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronarë ose zotërues të interesit në pronën e cila gjendet në këtë pjesë ose avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.

6. Çdo person i lartpërmendur do t'i jepet mundësi e arsyeshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojariht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafet 2 deri 4 të nenit 9 të Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 .

7. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt

zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqesues i ligjshëm i atij zyrtari publik, pronari ose zotëruesi të interesit.

8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronën e paluajtshme, do të mbahet më datën 11.08.2022, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut.

9. Në rast se prona e cila është objekt i shpronësimit, pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të iniciuar në përputhje me atë kërkesë, asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmiresimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbylljes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të "Ligjit nr. 03 / L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205.

10. Çdo person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në këtë parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëher duhet të dërgojë në Organin Shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e çertifikuara të çfarëdo dokumenteve që ndërlidhen me atë pretendim.





OBAVEŠTENJE

U prilog stavu 7.3 i 8.2 člana 8 Zakona br. 03/L-139, o eksproprijaciji nepokretnosti sa izmenama i dopunama Zakona br.03/L-205 od 28.70.2010.godine i Odluke Predsednika Opštine br.01 br.06-350/02-4729/ 22, proglašavaju se svi subjekti navedeni u Odluci u prilogu ovog obaveštenja da:

1. Na osnovu zakonskih odredbi na snazi kao i vodeći računa o javnom interesu, gde je Osnovna škola „Qamil Ilazi“, koja je u funkciji i koristi obeležene prostore za dvorište i sportske terene skoro 20 godina, koji prostori su okružen zajedno sa školom, na osnovu člana 4 stav 2 Zakona br. 03/L-739, za eksproprijaciju nepokretnosti sa izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-205, predsednik opštine je usvojio odluku br. 01 br. 06-350/02-4729/22, za dalji pregled postupka eksproprijacije nepokretnosti.

2. Predsednik opštine će doneti preliminarnu odluku u roku od 30 dana nakon ispunjenja uslova predviđenih članom 9. Zakona br. 03 / L-139, o eksproprijaciji nepokretne imovine sa izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-205, u vezi sa organizovanjem javnih rasprava.

3. Svako zainteresovano lice ima pravo da u roku od 10 kalendarskih dana, nakon objavljivanja Odluke predsednika opštine o daljem razmatranju zahteva za eksproprijaciju, podnese svoje pisane komentare povodom predložene eksproprijacije Organu za eksproprijaciju u Službeni list Republike Kosovo ili novinama sa velikim tiražom na Kosovu.

4. Opština će održati javnu raspravu u vezi tražene eksproprijacije za katastarske parcele br.01306-2, sa kulturom pašnjaka klase 4, površine 600 m², Z.K Kacanik i Vjeter i 01306-8 sa kulturom pašnjaka klasa 4, površine 600 m², Z.K Kacanik i Vjeter.

5. Pravo učešća na javnoj raspravi imaju sva lica koja su javni funkcioneri opštine u kojoj se održava javna rasprava ili vlasnici ili posjednici interesa u imovini koja se nalazi u ovom delu ili advokati ili zakonski zastupnici ovih lica.

6. Svakom pomenutom licu će se dati razumna mogućnost da usmeno izrazi svoje mišljenje u vezi sa traženom eksproprijacijom u skladu sa stavovima 2 do 4 člana 9 Zakona br. 03 / L-139, o eksproprijaciji nepokretne imovine sa izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-205.

7. Svako lice koje želi da učestvuje ili izrazi svoje mišljenje na javnoj raspravi mora sa sobom poneti razumne dokaze (dokumente) koji dokazuju da je u stvari

javni funkcioner, vlasnik ili vlasnik interesa ili punomoćnik ili zakonski zastupnik tog javnog funkcionera, vlasnika ili vlasnika interesa.

8. Javna rasprava u vezi sa traženom eksproprijacijom prava svojine ili drugih prava na nepokretnosti održaće se 11.08.2022.godine u 10:00 časova, u sali Skupštine opštine Kačanik.

9. U slučaju da je imovina koja je predmet eksproprijacije, nakon okončanja postupka eksproprijacije pokrenutog u skladu sa tim zahtevom, neće biti isplaćena naknada za troškove ili vrednost bilo kakvog poboljšanja imovine, izgrađenih objekata ili prošireno u imovini, ili drveće ili biljke zasađene u imovini nakon datuma ispunjenja relevantnih odredbi stava 8 člana 8 „Zakona br. 03/L-139, o eksproprijaciji nepokretnosti sa izmenama i dopunama prema Zakonu br. 03 /L-205.

10. Svako lice koje nije navedeno u obaveštenju koje tvrdi da ima imovinski interes ili drugi pravni interes u ovoj parceli nepokretne imovine opisanoj u obaveštenju mora odmah poslati organu za eksproprijaciju opis svog zahteva. , pravni osnov za tu tvrdnju kao i overene kopije svih dokumenata u vezi sa tim zahtevom.



Direktor DUKMM
Damil Stagova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



01 Nr.06-350/02-4729/22
Kaçanik 20.04.2022

Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 2, nenit 8, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së palujtshme, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-205, të nenit 13 dhe 58 Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës" nr. 28/ 15 Qershor 2008), nenit 6.2 shkronja a) dhe h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Vendimit të Kuvendit Komunal të Kaçanikut 01 Nr.06-350/02-4729/22 për Shpalljen e Interesit Publik dhe kërkesës për Shpronësim të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, më datë 20.04.2022 merr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET kërkesa për iniciimin e procedurës për shqyrtim të metejshëm Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit për shpronësim të pronës së palujtshme, pra për parcelat kadastrale nr.01306-2, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 600 m², Z.K Kačanik i Vjetër e cila evidentohet në emër të Mustafë (Isuf) Lama dhe 01306-8 me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 600 m², Z.K Kačanik i Vjetër e cila evidentohet në emër të Radojka (Zora) Gjorgjeviq.

II. Vlera e kompenzimit të pasurive të palujtshme të theksuara më lartë do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përfitojnë pronarët dhe zotëruesit e interes të cilët preken nga procesi i shpronësimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financa-Komisioni i vlerësimit dhe do të kompenzohen nga ana e Komunës së Kaçanikut.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

IV. Vendimi hyjë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Web faqës së Komunës.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke e marr parasysh Interesin Publik, ku Shkolla Fillore "Qamil Ilazi" e cila është funksionale dhe hapsirat e larëshnuara i shfrytëzon për oborr dhe fusha sportive për afro 20 vite të cilat hapsira janë të rrethuara së bashku me shkollën. Këto patundëshmeri janë me karakter të interesit publik, prandaj Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2022 ka marrë vendimin 01 Nr.06-350/02-4729/22 për Shpalljen e Interesit Publik për parcelat kadastrale të lartëshnuara.

I dërgohet:

Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,

Arkivit të Komunës dhe Web faqës së Komunës.



Kryetari
Besim Ilazi